



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. LEONARDO (ALTIN) GJOVALIN NIKOLLI, ANËTAR I KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 14.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, anëtar i këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 2, neni 4, neni 6 i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, pika 12, 13 i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:



Nr. 340 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Leonardo Gjovalin Nikolli, anëtar i këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- Deputetët të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

Anëtari i Këshillit të Bashkisë Mirditë, z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, në bazë të listës shumemërore të subjektit politik, Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit më datë 03.05.2016 me numër unik 1712, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, anëtar i Këshillit të Bashkisë Mirditë, rezulton se:

- në pikën B të formularit të vetëdeklarimit, gjenealitete të mëparshme ka deklaruar se ka ndryshuar emrin nga "Altin" në "Leonardo";
- në pikën 7 të formularit të vetëdeklarimit "A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?" ka deklaruar se në fund te vitit 2007, është dëbuar për arsye probleme me dokumentat nga Lion, Francë, dhe të dhënat për aktin e dëbimit nuk i disponon.

Me shkresën nr. 3689/6 prot., datë 09.06.2016 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar në KQZ, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, nr. 16 prot., datë 31.05.2016, të z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, sipas të cilit rezulton se: z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, me vendim gjyqësor të formës së prerë, nr. 98, datë 30.05.2008, është deklaruar fajtor për krimin e përdorimit të vizave të falsifikuara të parashikuara nga neni 189/1 K.P, e në bazë të kësaj dispozite e nenit 406 të K.Pr.P është dënuar me 4 (katër) muaj burgim e 270.000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë gjobë. Në vështrim të kërkesave të nenit 59, të K.P pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi për dënimin me burgim duke e vënë në prove për 18 (tetëmbëdhjetë) muaj që ai të mos kryejë vepër aq të rëndë apo më të rëndë.

Gjoba të paguhet deri më datë 30.04.2009.

Sipas Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore, për këtë vepër penale, në bazë të nenit 69 të Kodit Penal, është rehabilituar.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe vërtetimit e gjendjes gjyqësore, rezulton se z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, nuk e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dënimin për veprën penale "Përdorim i vizave të falsifikuara", parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal sipas vendimit nr. 98, datë 30.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Me shkresën nr. 567 prot. datë 03.02.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka kërkuar Prokurorisë së Përgjithshme verifikimin e thelluar për anëtarin e këshillit bashkiak Mirditë, z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli.

Me shkresën nr. 1266/1 prot., datë 03.05.2019 Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Mardhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin e rezultatit të verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, me funksion anëtar i Këshillit të Bashkisë Mirditë.

Sektori i Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme, ka vijuar procesin e verifikimit të thelluar të të dhënave të pasqyruara në formularin e vetëdeklarimit, të z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, duke ju drejtuar me kërkesa zyrtare disa institucioneve shtetërore. Nga përgjigjet e ardhura rezulton se:

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 623/1 prot., datë 21.02.2017, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentin "Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore



Nr. 340 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, anëtar i këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

nr. 11, datë 20.02.2017, ku rezulton se z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, figuron me statusin "I Dënuar", brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. "Me vendimin nr. 98, datë 30.05.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është deklaruar fajtor për krimin e "Përdorimit të vizave të falsifikuara", parashikuar nga neni 189/1 i K.P dhe në zbatim të nenit 406 të K.Pr.P është dënuar me 4 (katër) muaj burg e 270.000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë gjobë. Pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor, për sa i përket dënimit me burgim në vështrim të kërkesave të nenit 59, të K.P, duke e vënë në provë, për një periudhë 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, që të mos kryejë asnjë vepër penale kaq të rëndë apo më të rëndë".

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 1289/1 prot., datë 24.02.2017, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave rezulton se subjekti më datë 13.05.2005, ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën emrin nga "Altin" në "Leonardo".
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresë nr. 223/1 prot., datë 23.02.2017, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme, kopje të vendimit penal të formës së prerë nr. 98, datë 30.05.2008, në ngarim të z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli. Sipas këtij vendimi në dispozitiv rezulton: "Deklarimin fajtor të pandehurit z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, për veprën penale të "Përdorimit të vizeve të falsifikuara", parashikuar nga neni 189/1 i K.P dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burg e 400.000 (katërqind mijë) lekë gjobë. Duke aplikuar kërkesat e nenit 406, të K.Pr.P të dënohet me 4 (katër) muaj burgim dhe 270.000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë gjobë. Pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor, për sa i përket dënimit në vështrim të kërkesave të nenit 59 të K.P, ku i pandehuri z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, të vihet në provë, për një periudhë 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, që të mos kryejë asnjë vepër penale kaq të rëndë apo më të rëndë.
- Zyra Qendrore Kombëtare e Interpol Tiranë, me shkresën nr. 299/1 prot., datë 24.02.2017, ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme informacionin se "Sipas autoriteteve franceze, ka rezultuar një shtetas i quajtur z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, i arrestuar në një tren nga policia kufitare në Modane (pranë kufirit me Italinë) duke përdorur dokumenta të falsifikuara. Kjo ngjarje është regjistruar në sistem më datë 01.10.2007".
- Me shkresë nr. 43 prot., datë 09.01.2019, i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë, "Kërkesë për ndihmë juridike drejtuar Autoriteteve të Republikës së Greqisë", me objekt vënien në dispozicion të informacionit të plotë lidhur me shtetasin shqiptar z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, alias Altin Nikolli. Nga autoritetet greke nuk është kthyer ende përgjigje.
- Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMES, rezulton se z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, në datë 09.10.2007 është shoqëruar në Drejtorinë e Policisë Tiranë, pasi në pasaportën e tij ndodhej një leje qëndrimi greke e falsifikuar. Për këtë fakt ai është dënuar me vendimin penal nr. 98, datë 30.02.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Subjekti rezulton se nuk e ka deklaruar këtë informacion, dhe pse ka patur detyrimin ligjor për ta pasyruar në formularin e vetëdeklarimit dhe konkretisht në pikën 3 të formularit "A keni qënë ndonjëherë në hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?" dhe pikën 4 të formularit, "A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale?". z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, i është përgjigjur me "Jo" të dyja pyetjeve më sipër.



Nr. 340 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Leonardo Gjovalin Nikolli, anëtar i këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në KREUN III, pika 3, ç), thuhet se formulari (që plotësohet dhe firmoset nga subjektet vetëdeklarues) përmban një rubrikë që detyrimisht pasqyrohet se "...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të, *passjell përjashtimin e menjëhershë dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik*".

Duke nënshkruar faqen e dytë të formularit II, "Marrja dijeni mbi efektet e formularit dhe të vetëdeklarimit", pika d) "Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike", passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i menjëhershëm i funksionit publik", subjekti mban përgjegjësinë e plotë dhe është i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tij kriminale.

Prokuroria e Përgjithshme ka analizuar veprën dhe dënimin e vendimit nr. 98, datë 30.05.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe ka konkluduar se subjekti deklarues z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, me detyrë anëtar i këshillit bashkiak Mirditë:

- përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa "ç" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kjo e provuar sipas vendimit penal, nëpërmjet së cilit është deklaruar fajtor për veprën penale "Përdorim i vizave të falsifikuara", parashikuar nga neni 189/1 i K.P për të cilën është dënuar me 6 (gjashtë) muaj burgim e 400.000 (katërqind mijë) lekë gjobë;
- përfshihet në fushën e veprimit të pikës 3, germa "ç", kreu III, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "ku thuhet se "Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik". Në përgjigje të pyetjes 1 të faqes 3, të formularit të vetëdeklarimit se "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?", subjekti ka deklaruar "Jo". Pra rezulton se nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit vendimin penal të formës së prerë, nr 98, datë 30.05.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me të cilin kjo gjykatë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale të "Përdorimit të vizave të falsifikuara" parashikuar nga neni 189/1 i K.P dhe dënuar me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe 400.000 (katërqind mijë) lekë gjobë. Subjekti ka patur detyrimin dhe mundësinë për ta deklaruar në formular këtë vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i dokumentacionit, formularit të vetëdeklarimit, vërtetimit të gjendjes gjyqësore, Vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme "Për miratimin e rezultateve të verifikimit" nr. 1266/1 datë 03.05.2019, KQZ-ja konstaton se:

Z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, anëtar i Këshillit Bashkiak Mirditë, është dënuar në vitin 2008 për kryerje e veprës penale "Përdorim i vizave të falsifikuara", parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve referuar pikës 12 dhe 13 të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, për të vlerësuar nëse z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, është apo jo në kushtet e moszgjidhshmërisë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet ti jap përgjigje dy pyetjeve:

1. Nëse të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, apo të dhënat e gjendura në regjistrat publike, të cilët janë regjistra zyrtare përfshihen në kushtet e parashikuara nga neni 2 i ligjit nr. 138/2015.
2. Nëse ekzistojnë të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga nenin 2 i ligjit 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nëse ato përfshihen brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 138/2015.



Nr. 340 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Leonardo Gjovalin Nikolli, anëtar i këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Referuar gërmës "ç", të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

Referuar nenit 2, pika 1, gërma "ç", e ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, "Përdorim i vizave të falsifikuara", parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal, përfshihet në fushën e veprimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike".

Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sa më sipër momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë është data 09.12.2008. Referuar pikës 3 dhe 6 të nenit 4 të ligjit nr. 138/2015, duke i shtuar datës 09.12.2008, 5 vjet, periudha e ndalimit për kandidim zgjedhje apo ushtrim funksionit për z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, (alias Altin Nikolli) ka përfunduar më datë 08.12.2013.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....

Për personat që parashikohen nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

.....

Për personat e dëbuar sipas parashikimeve të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, kohëzgjatja e ndalimit për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit është:

- i) përjetë për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 1, shkronja "a";
- ii) 20 vjet për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 1, shkronja "b";

iii) 10 vjet për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 1, shkronja "c", pavarësisht uljes së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit.

.....

Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit.



Nr. 340 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Leonardo Gjovalin Nikolli, anëtar i këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Referuar nenit 4, pika 3, të ligjit nr. 138/2015, periudha e ndalimit për ushtrimin e funksionit për personat e dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 2, pika 1, germa "ç", e këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar nenit 4, pika 6, paragrafi "III", parashikon se për personat e dëbuar sipas parashikimeve të gërmës "b" të pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, kohëzgjatja e ndalimit për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit është 10 vjet për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 1, shkronja "c", pavarësisht uljes së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit.

Referuar të dhënave të Prokurorisë së Përgjithshme:

- Zyra Qëndrore Kombëtare e Interpol Tirana me shkresën nr. 1728 KL/2 prot., LA - 96/2017 datë 24.02.2017. ka përcjellë pranë Prokurorisë së Përgjithshme informacionin se "z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, lindur më 20.10.1981, në Klos, Mirditë, është regjistruar nga autoritetet policore të Modane (Francë), më datë 30.09.2007 për qëndrim të paligjshëm".
- Zyra Kombëtare e Europol Tiranë, me shkresën nr. 299/1 K prot., datë 24.02.2017, ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme informacionin se "sipas autoriteteve franceze, ka rezultuar një shtetas i quajtur z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, i arrestuar në një tren nga policia kufitare në Modane (pranë kufirit me Italinë), duke përdorur dokumenta të falsifikuara. Kjo ngjarje është regjistruar në sistem më 01.10.2007".

Me shkresën nr. 182 prot., datë 16.02.2017 i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë, "Kërkesë për ndihmë juridike drejtuar Autoriteteve të Republikës së Francës", me objekt vënien në dispozicion të informacionit të plotë lidhur me shtetasin shqiptar z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, alias Altin Nikolli. Nga autoritetet franceze nuk është kthyer përgjigje në lidhje me këtë kërkesë.

Me shkresën nr. 43 prot., datë 09.01.2019 i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë, "Kërkesë për ndihmë juridike drejtuar Autoriteteve të Republikës së Greqisë", me objekt vënien në dispozicion të informacionit të plotë lidhur me shtetasin shqiptar z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, alias Altin Nikolli. Nga autoritetet greke nuk është kthyer përgjigje në lidhje me këtë kërkesë.

Prokuroria e Përgjithshme nuk ka referuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të dhëna që lidhen me vërtetimin e kushteve të parashikuara në nenin 2, germa "b" të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike".

Referuar vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale, "Përdorim i vizave të falsifikuara", parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal, vendimit, nr. 98, datë 30.05.2008, të Gjykatës së Rrethit Lezhë, z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, për kryerjen e kësaj vepre penale, nuk është brenda periudhës së ndalimit për zgjedhjen në funksionin e këshilltarit në këshillin e bashkisë Mirditë, pasi vepra penale është rehabilituar.

Në lidhje me faktin nëse mosdeklarimi i të dhënave të cilat parashikohen në pyetjet e formularit të vetëdeklarimit, përbëjnë shkak për ndalimin e ushtrimit të funksionit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është shprehur gjerësisht rast pas rasti dhe në vendimet e mëparëshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar praktikave të deritanishme ka vlerësuar individualisht për çdo funksionar publik, të trajtuar sipas ligjit nr. 138/2015, të dhënat e padeklaruara, arsyen nëse fshehja e tyre nga deklarimi është e qëllimshme apo jo si dhe në rastin e mosdeklarimit të gjeneraliteteve të mëparëshme, nëse këto të fundit funksionari i publik i ka përdorur për një qëllim të caktuar apo janë ndryshime të cilat janë bërë gjatë jetës për të saktësuar gjenealitetet e tyre pranë zyrave të gjendjes civile përkatëse.



Nr. 340 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, anëtar i këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, duke mos e shënuar një dënim me vendim gjyqësor të formës së prerë, për të cilin është jashtë periudhës së ndalimit, ka deklaruar se nuk ka asnjë shkak për të mos kandiduar, për të mos u zgjedhur, apo mos emëruar sepse pavarësisht se ai është dënuar me një vendim të formës së prerë, por që është jashtë periudhës së ndalimit, ky lloj dënimi nuk është shkak për të mos u zgjedhur, mos u emëruar apo për të humbur funksionin që ka.

Mosdeklarimi në këtë rast nuk përbën shkak për fshehje të qëllimshme, pasi të dhënat e mosdeklaruarja janë të dhëna të cilat janë në regjistrat publik, të cilat janë regjistra zyrtar të institucioneve shtetërore.

Këto të dhëna referuar ligjit nr. 138/2015 dhe vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, janë të dhëna të cilat do të disponohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në çdo rast, mosdeklarimi i tyre nuk shmang verifikimin e plotë dhe të gjithëanshëm.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016", konstaton se: "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka interpretuar dhe ka vendosur drejt, duke vlerësuar se individët që janë subjekt i këtij ligji duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të së cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve të parashikuara nga ky ligj dhe që përbëjnë ndalim për të kandiduar, për t'u zgjedhur ose emëruar. Qëllimi i ligjit nr. 138/2015, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të atyre personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t'u zgjedhur, apo emëruar, por jo të personave që, për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme apo të paplota në raport me të dhënat e gjendura në regjistrat publike, të cilët janë regjistra zyrtare e që nuk plotësohet me vetëdeklarim, por sipas procedurave të posaçme ligjore, apo të tjerë që kanë deklaruar të dhëna shtesë pas përfundimit të afatit të deklarimit".

Bazuar në gërmën "ç", pika 1, neni 2 dhe nenit 4 pika 4 e ligjit nr. 138/2015, Z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, kandidat për anëtar në këshillin e Bashkisë Mirditë, propozuar nga subjekti politik Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, përfshihet në fushën e veprimit të ligjit nr. 138/2015, por është jashtë periudhës së ndalimit.

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 10, pika 1, germa "c" dhe nenit 11, pika 2, e ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" konstaton se z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, me të dhënat për dënim për kryerjen e veprës penale, "Përdorim i vizave të falsifikuara", dhe mos deklarimin e tyre nuk është në kushtet e pasqyrimin të të dhënave të paplota, sipas parashikimeve të nenit 2, pika 1, germa "ç", nenit 4, pika 4 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Për sa më sipër subjekti deklarues z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.



Nr. 340 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, anëtar i këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 2, , neni 4, neni 6 i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, pika 12, 13 i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Vazhdimin e mandatit të z. Leonardo (Altin) Gjovalin Nikolli, me detyrë Anëtar në Këshillin e Bashkisë Mirditë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 340 i vendimit Data 14.05.2019 e vendimit Ora 14:00 e vendimit

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Leonardo Gjovalin Nikolli, anëtar i këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".